

Prof. dr. Emin RIZA

BANESA TRADICIONALE GJAKOVARE

Copëzimi i trojeve shqiptare dhe vetëmbyllja gjysmë shekullore e Shqipërisë në regjimin komunist, vështirësuan deri në pamundësi edhe studimin e trashëgimisë së kulturës materiale shqiptare në shekuj. Vitet e fundit po krijohen kushtet për studimin e kësaj pasurie të pazëvendësueshme historiko-kulturore në kuadrin e natyrshëm të njësisë kulturore shqiptare në shekuj.

Në bashkësinë e gjerë të trashëgimisë kulturore një vend të veçantë zë gjinia e banesës popullore të së kaluarës, apo banesa tradicionale. Cilësimi i saj si bashkësi ndërtimesh të veçanta, krahas kriterit tipologjik, kryhet edhe sipas shtrirjes hapësinore. Kështu në kontekste të ndryshme mund të flitet për banesë tradicionale evropiane, ballkanike, shqiptare dhe më ngushtas labe, beratase, apo gjakovare. Me banesë tradicionale gjakovare do të kuptojmë banesat e ndërtuara përpara se të zbatohet ndërtimi i banesave, një apo më shumë familjare, projektuar prej arkitektësh. Banesa tradicionale gjakovare, ashtu si mbarë ajo shqiptare, i përket periudhës para shek. XX, pa pasur kuptueshëm një hapësirë të saktë kohore. Dëshmitë e prekshme të kësaj trashëgimie janë banesat e vjetra në shkallë të ndryshme autenticiteti, ndërsa burimet e shkruara janë sa fragmentare aq edhe të pakta. Shembujt që ruhen ende sot, apo që janë të dokumentuara teknikisht, pas Luftës së Dytë Botërore, i përkasin kryesisht shek. XVIII-XIX. Duke pasur parasysh zhvillimin e ngadalshëm ekonomik të periudhës kur trojet shqiptare qenë nën suazën e perandorisë turke, në kuadrin e hipotezës, mund të pohojmë se shembujt e shek. XVIII - XIX, duhet të jene njohur dhe një apo dy shekuj më parë, natyrisht me arritje më modeste në planin kompozicional dhe atë të trajtimit arkitekturor.

Ashtu si në mbarë qytetet shqiptare të shek. XV-XIX, edhe

banesa e qendrës qytetare të Gjakovës, bën pjesë në tipologjinë e banesës tradicionale qytetare shqiptare. Për arsye jashtëshkencore, njohja dhe studimi i banesës tradicionale të Gjakovës, ashtu si banesës kosovare në përgjithësi, nuk ka ecur në rrugën e pritur dhe ka mbetur jashtë përfshirjes së natyrshme në tipologjinë e banesës shqiptare.

Gjakova, ashtu si shumica e qendrave qytetare shqiptare dhe ballkanike e më gjerë, gjatë shek. XV–XIX, në dallim prej qendrave qytetare me fillesa vendbanimet rrethuar me mure mbrojtëse, shfaqet si njësi e banuar me kalimin shkallë-shkallë prej qendrës fshatare në atë qytetare. Ky kalim në rastin e Gjakovës, lidhet me pozicionin e kësaj qendre dhe vitalitetin e banorëve të saj, për t’u përfshirë në veprimtari zejtare, duke u larguar gradualisht prej kultivimit të bujqësisë dhe rritjes së bagëtive. Dokumente me interes për zhvillimin e Gjakovës janë të dhënat demografike duke filluar prej shek. XV.

Në vitin 1484, Gjakova kishte 54 banesa, ndërsa në vitin 1591 ky numër u zvogëlua dhe arriti në 45. Shekulli XVII, shënoi fillimin e rritjes së Gjakovës, e cila po merrte tiparet e një qendre zejtaro-tregtare. Në vitet 1641–1642 Gjakova kishte 292 banesa, ndërsa në vitet 1856–1897, ajo kishte 22192 banorë, pra rreth 4400 banesa. Nga sa u parashtrua mund të pohohet se gjatë shek. XVII–XIX, Gjakova pëson një rritje të shpejtë për t’u kthyer në qendër të rëndësishme zejtaro-tregtare. Pazari i Gjakovës, ngritur në zonën qendrore të qytetit, përreth xhamisë së Hadumit, ngritur në vitet 1494–1495, është dëshmi e prekshme e rolit të zejtarisë në zhvillimin e qytetit. Gjakova në vitet 1830–1840 kishte rreth 650 dyqane, shumë hane, hamame etj.

Lagjet e banuara të Gjakovës, ashtu si edhe pazari, nuk janë paraprirë prej planesh urbanistike, por janë formuluar sipas urbanistikës spontane, e cila kishte disa parime lidhur me formulimin e rrugëve, marrëdhëniet e tyre me ndërtimet dhe ato ndërmjet vetë ndërtimeve.

Në bashkësinë e ndërtimeve të Gjakovës, në të kaluarën, ashtu si dhe sot, vendin kryesor e zë gjinia e banesës. Edhe banesat tradicionale të Gjakovës, ashtu si shumica e atyre mbarëshqiptare në tiparet e tyre thelbësore projektuese, kompozicionale dhe teknike, ndjekin parimet tashmë të njohura. Kështu momenti i

projektimit, i cili kryesisht është meditativ, nuk paraqitet me mjetet e sotme grafike, por është përfundim i marrëveshjesh ndërmjet porosities, pronarit të banesës dhe kryemjeshtër, i cili udhëheq grupin e mjeshtërve që zbatojnë punimet. Teknikat dhe materialet e ndërtimit, janë njohur dhe përdorur, gjatë shekujve, në mbarë hapësirën ballkanike dhe më gjerë. Ndër faktorët thelbësorë ndikues në kompozimin e banesave tradicionale shqiptare, pra dhe atyre të Gjakovës, janë ata shoqërorë, forma dhe karakteri i truallit të ndërtimit, klima e rajonit, lloji i materialeve natyrore etj.

Siç e përmendëm, banesa tradicionale gjakovare në shembujt të cilët ende ruhen pjesërisht, apo plotësisht d.m.th. me shkallë të lartë autenticiteti, i përket periudhës së përfshirjes së hapësirave shqiptare në suazën politike të Perandorisë Osmane. Për arsyet e njohura, ndër të cilat më e rëndësishmja është ajo e pavarësisë së tipit të banesës prej etnosit sundues, banesat tradicionale, në trojet shqiptare të përfshira në Perandorinë Osmane janë thjeshtë shqiptare.

Siç përmendëm, qytetet shqiptare gjatë periudhës së shek. XV-XIX, duke qenë qendra zejtaro – tregtare në rritje, nuk u shkëputën plotësisht prej lidhjes me ekonominë bujqësore–blegtorale. Familjet gjakovare që kishin të ardhura kryesisht prej ushtrimit të zejtarisë, kishin edhe troje bujqësore në rrethinat e qytetit dhe mbanin bagëti për nevoja familjare. Familjet, përgjithësisht të varfëra në pjesën periferike të qytetit, ushtronin thujse plotësisht ekonominë bujqësore–blegtorale. Kjo rrethanë ka ndikuar si në kompozimin e oborrit të banesës (pjesë organike e saj) ashtu dhe në vetë kompozimin e saj dhe funksionet e kthinave të ndryshme.

Banesa qytetare kosovare e shekujve XVIII–XIX, e cila në shembujt e thjeshtë është njohur edhe shekuj më parë, në tipologjinë e saj përfshihet në kuadrin e banesës qytetare shqiptare të mesjetës së vonë. Duke u përfshirë në këtë tipologji, ajo nuk përmbledh mbarë tipat, ndërsa në vetë tipat e ndërtuar edhe në Gjakovë, shfaqen veçanti lokale.

Në qytetin e Gjakovës, prej gjurmimit të banesave të vjetra që ruheshin, apo ndeshen ende, vërejmë se ruhen katër tipa banesash tradicionale dhe pikërisht tipat e banesës me hajat, banesa me çardak, banesa me qoshk dhe kulla qytetare, krahas zgjidhjeve të veçanta, dukuri sa e njohur aq edhe e kuptueshme. Nga vrojtimit

e derisotme, mund të pohohet se radhitja e mësipërme e tipave është njëherazi një vendosje në kronologji relative.

Të tre tipat e parë të banesës gjakovare, ndeshen në mbarë qytetet shqiptare të kohës, ndërsa kulla si banesë, paraqet një tip të përhapur vetëm në disa qytete të Kosovës.

Banesa tradicionale e Gjakovës, në mbarë tipologjinë e saj, përmban një repertor kthinash me funksione të ndryshme, kompozimi i të cilave nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me tipin e banesave. Këto kthina përgjithësisht të mbyllura si dhe ato të hapura (hajatit dhe çardakut) kanë kompozime me tipologji të qartë, duke qenë se janë kompozime me zhvillime në kohë. Krahas ndarjes në kthina të hapura dhe të mbyllura, një ndarje tjetër paraqet ajo e kthinave të pabanuara dhe atyre të banuara. Volumet formuese të banesës gjakovare janë: ahri, shtëpia e zjarrit, oda, qoshku, hapësira sanitare, hajati dhe çardaku.

Banesa gjakovare përgjithësisht nuk ka hapësira të pabanuara, siç vërehet në banesat qytetare të Shqipërisë politike. Megjithëkëtë, në disa shembuj të banesave me hajat dhe atyre me çardak ndërtohen një apo disa kthina, nën katin përdhe, të cilat përgjithësisht janë të pabanuara duke pasur funksione ndihmuese. Edhe në katin përdhe të disa banesave me çardak, ndeshim një apo shumë kthina të pabanuara. Këto hapësira janë të pasuvatuara, pa shtresa dhe pa tavan. Hyrja në to arrihet drejtpërdrejt nga jashtë, apo më rrallë me shkallë të brendshme nga kati mbi të.

Shtëpia e zjarrit, është hapësira gjithherë e pranishme në tipologjinë e banesës gjakovare, si mjedisi me funksione qëndrimi dhe gatimi. Ai ndërtohet në pjesën fundore të banesës, duke pasur vendin e zjarrit, fillimisht të hapur dhe më pas në oxhak. Përgjithësisht shtëpia e zjarrit është pa tavan, me ndriçim të vogël dhe në disa kompozime ka edhe ndërlidhje të drejtpërdrejtë me oborrin.

Oda, ashtu si në mbarë banesat, përbën hapësirën kryesore të ndërtimit. Vendosja e tyre në kompozimin e banesës lidhet me tipin e banesës, ndërsa trajtimi i këtyre hapësirave shfaqet thuajse i njësuar, duke pasur dallime në përpunimin arkitektoniko-dekorativ të elementëve të ndryshëm formues të odës, si pasqyrimi i gjendjes ekonomike të familjes. Në karakterizimin kompozicional të odave në Gjakovë, ashtu si në mbarë Kosovën, ku gjejmë

një pajimi funksionalo-arkitekturor të pjesës fundore të odës, me zgjidhje deri diku të standardizuara. Në këtë pjesë, thuhet gjithmonë, ndeshim në instalimin e ngrohësit, i cili formohet prej furrës ku ndizej zjarri, që është i pajisur me kanal tymtërheqës. Furra lidhet me ngrohësin, që ngrihet në odë, në të cilin qarkullonte ajri i ngrohtë. Ky i fundit depërton edhe në nënshtresën e banjës, ndërsa prej furrës ngrohet dhe një enë uji në hapësirën e banjës. Krahas, në këtë pjesë, me kompozime të ndryshme, ndeshim bllokun e musandres, apo musandrave dhe etazherëve. Në disa raste një parrmak i ulët druri, ndan pjesën fundore prej hapësirës së odës. Për shkak të lartësisë krahasimisht të ulët të odës, në këto banesa nuk ndeshim volumin e trapazanit mbi atë të musandrave. Hapësira e odës është e shtruar me dysheme dërrase dhe tavan dërrase, apo me suvatim. Kamaret dhe dollapët e murit, janë shfaqje e zakonshme në odë. Ndriçimi, përgjithësisht arrihet me dritare në formë vargu në dy ballet, që sipas tipologjisë dalin në hapësirën e oborrit, apo edhe atë të hajatit, apo çardakut. Në bashkësinë e odave që arrijnë prej dy deri në gjashtë të tilla, vend të veçantë zë oda e miqve, e cila dallohet prej odave të tjera në vendosjen pranë hyrjes për në banesë dhe sidomos dekoracionit të pasur si në elementet e drurit, ashtu edhe në ato të suvatuara.

Qoshku, është një hapësirë e njohur gjerësisht në tre tipat kryesorë të banesë gjakovare. Ai është një volum i hapur apo i mbyllur i cili ndeshet në hapësirat e hajatit dhe çardakut, apo si vazhdim i hapësirës ndërlidhëse në banesën me hajat. Ai ka funksione qëndrimi dhe është i hapur apo i mbyllur.

Mjedisi sanitar, shpesh i bashkëngjitur banjës është një kthinë gjithëheri e pranishme në banesën në shqyrtim. Odat e gjumit kanë atë pjesë të përhershme të tyre, si ndikim turko - oriental, shenjë e kulturës së jetesës dhe banimit më ngushtas.

Hajati është një volum me pamjen kryesore, apo edhe atë anësore, të hapur, i cili ndërtohet në pjesën ballore të banesës përdhese më hajat, apo në pjesën ballore të çardakut të banesës së hapur me kat. Hajati ka funksione ndërlidhëse, si dhe shpesh volumin që shërben për qëndrim në stinët e ngrohta. Në kushtet e klimës së ftohtë të Kosovës, qoshku si pjesë e hajatit apo çardakut ndërtohet i mbyllur që në krye, duke u veshur në ballë dhe eventualisht anash me një perde me lëndë druri me dritare të shumta, të cilat duke u hapur në

stinët e ngrohta, thuhet se e hapin plotësisht hajatin apo çardakun. Ky i fundit, hapësira e rëndësishme funksionale e banesës me kat që merr emrin prej saj, krahas funksionit ndërlidhës me ndërtimin e një apo më shumë qoshqeve, merr funksione të mirëfillta banimi në stinët e ngrohta.

Repertori i banesës gjakovare nuk është i vetmi përbërës i banesës në fjalë, e cila në kuptimin tradicional dhe atë juridik përfshin mbarë hapësirën brenda mureve rrethues të banesës, pra dhe oborrit. Në Gjakovë, qendra e banuar ngritur mbi rrafsh, me hapësira trojesh krahasimisht të gjera, banesat përgjithësisht kanë pasur oborre të gjera, më së shumti përpara banesës. Vetë banesat rrallë dilnin në rrugë dhe kur vërehej kjo dukuri, ishte fjala për ballët fundorë, apo anësorë, thuhet të shurdhër, pra pa hapësira dritaresh. Oborri i banesës gjakovare përfshinte pjesën ku mbilleshin pemë, zarzavate dhe lule. Në ballin e oborrit, në të cilin ndërtohej porta e jashtme e gjerë dykatëshe, përgjithësisht me një derë të dytë në njërin flegër, apo pranë saj, ngrihej një ndërtim me kat, poshtë katua dhe sipër shtëpi miqsh, apo dy ndërtime të tillë përbri portës. Pusi, kosheret e drithërave dhe portat që ndërlidhnin oborrit me atë të fqinjëve, ishin thuhet një konstante.

Ashtu si në klasifikimin e banesës shqiptare në përgjithësi dhe asaj qytetare në veçanti dhe në rastin në shqyrtim të banesës gjakovare, klasifikimi mbështetet në kriterin thelbësor atë të kompozimit volumor. Ky kompozim shfaq bashkëmarrëdhëniet funksionale ndërmjet kthinave të banesës në lartësi, pra sipas kateve dhe në rrafsh sipas secilit kat. Kompozimi është i drejtpërdrejtë me rrethanat ekonomiko - shoqërore të vendbanimit në tërësi dhe më ngushtas të subjektit porosites dhe njëherazi bashkëkompozues të banesës.

Banesa gjakovare, ashtu si banesa qytetare kosovare, shfaqet, kryesisht gjatë shek. XVIII - XIX, në katër tipa. Këta tipa, ashtu si tradicionalisht, përgjithësisht emërtohen sipas një hapësire bashkëformuese të banesës, e cila për pozicionin e saj në kompozim bëhet cilësuese e tipit.

Sipas kriterit kompozicional banesa tradicionale gjakovare ndahet në katër tipa, banesa me hajat, banesa me çardak, banesa me qoshk dhe kulla. Këtyre kategorive i shtohen natyrshëm, zgjidhjet e veçanta, përgjithësisht me nomeklaturë të njëjtë, apo të

afërme kthinash, por me kompozime që shkëputen prej tipologjisë së përmendura për arsye të ndryshme.

Banesa me hajat, është tipi më i lashtë i banesës gjakovare, ashtu si dhe i mbarë hapësirës ballkanike. Shembujt e banesës me hajat të Gjakovës, gjithë duke ruajtur karakteristikat thelbësore të tipit paraqiten me veçanti dhe arritje të veçanta. Tipi i banesës me hajat dallohet për kompozimin e thjeshtë me dy radhë kthinash në të njëjtin plan, duke pasur rreshti i parë i tyre hajatin, si pjesë e rëndësishme e tij. Hajati, është një volum i hapur apo i kufizuar në ballë, apo edhe anash me një varg dritaresh të njëpasnjëshme të ndërtuara në një strukturë me skelet druri. Hajati, ka funksione ndërlidhëse dhe kryesisht funksione banimi në stinët e ngrohta, të cilit funksion i shërbejnë qoshku, apo qoshqet e ngritur mbi rrafshin e hapësirës ndërlidhëse. Prej të tre nënvarianteve të këtij tipi me hajat në ballë, anash dhe në qendër, në Gjakovë sot dhe më herët, pas Luftës së Dytë Botërore, ruhen vetëm variantet me hajat në krah dhe më rrallë me hajat në qendër. Kompozimi i banesës në volum, shpesh ka edhe një kat të ulët, pjesërisht nën tokë, përgjithësisht me ndërlidhje së jashtmi.

Siç përmendëm, banesa me hajat është kompozuar me dy radhë kthinash. Në atë fundoren ndërtohet gjithmonë shtëpia e zjarrit, shpesh me vend zjarri në mes, pra pa oxhak dhe një kthinë përbri. Në variantet me hajat anash dhe në qendër, kthinat përbri hajatit, apo njëra prej tyre është oda e miqve. Banesa gjakovare me hajat, dallohet për kompozimin e ngjeshur dhe shpesh një lloj mbyllje me dritare të shumta, për shkak të kohës së ftohtë në dallim prej hapësirës shqiptare në jugperëndim të Kosovës. Kompozimi i mbarë kthinave të banesës me hajat, si dhe i banesës tradicionale gjakovare në përgjithësi, ruan tiparet thuajse të njësuara për periudhën në shqyrtim.

Banesa gjakovare me çardak është zhvillim i mëtejshëm volumor i banesës me hajat, duke shtuar një kat mbi përdhesin dhe duke pasur shpesh një nënkat të pjesshëm me funksione dytësore. Përgjithësisht, ashtu si në banesën me hajat, të dy katet e banesës me çardak, kompozohen me dy radhë kthinash, duke u formuar, më së shumti, ajo fundorja prej dy volumesh, njëri prej të cilëve, shtëpia e zjarrit. Në çardakun në një krah, apo në qendër, ndeshen qoshqe qëndrimi. Ashtu si dhe në banesën me hajat, çardaku në

banesat gjakovare të këtij tipi është përgjithësisht i mbyllur në pjesën ballore dhe atë anësore prej një perdeje me skelet druri, në të cilën vendosen radhazi dritare. Në banesën gjakovare me çardak, ndërlihdhja mes kateve kryhet me shkallë njërampëshe druri, përgjithësisht të vendosura paralel me faqen ballore të banesës. Pamja kryesore dhe anësoret e banesës me çardak janë të hapura, me shtylla në ballë dhe ballit të sipërm me dritare të shumta dhe strehët e hapura, shpesh dyfishe.

Tipi i banesës me qoshk është një dukuri, krahasimisht e vonë që shfaqet rreth gjysmës së dytë të shek. XIX dhe pati përhapje të gjerë si në Gjakovë, ashtu edhe në mbarë qytetet shqiptare. Kjo banesë i përgjigjej më mirë shtresave zejtaro – tregtare në rritje të vazhdueshme. Banesa me qoshk, merr këtë emërtim prej qoshkut të hapur, apo për të mbyllur në pjesën qëndrore të ballit të banesës, përgjithësisht të kompozuar simetrisht, përbri hapësirës qëndrore ndërlihdhëse ku zhvillohen shkallët.

Banesa me qoshk është përdhese dhe me kat. Në të dy rastet kompozimi është i thjeshtë. Në qendër ndërtohet hapësira ndërlihdhëse, në të cilin zhvillohen shkallët, kur banesa është me kat. Anash kësaj hapësire ndërtohen kthinat e banimit një apo dy të tilla, në secilin krah. Në rastin e banesës me kat, të dy katet përgjithësisht kanë kompozime simetrike. Qoshku, i ndërtuar gjithmonë në ballin e hapësirës ndërlihdhëse, dhe i dalë përtej sipërfaqes ballore, është i hapur apo i mbyllur. Qoshqet më të zhvilluar janë ata në banesat me kat. Ata dalin konsol, apo mbahen prej kolonash druri. Në disa shembuj të zhvilluar, qoshqet ndërtohen edhe në faqen e prapme të banesës, duke pasur kështu ajo dy pamje kryesore. Volumi i qoshqeve është përgjithësisht prizmatik me bazë katrori, katërkëndësh kënddrejtë, shumëkëndor, apo gjysmë rrethor. Në Gjakovë ruhen shembuj me vlera të spikatura arkitekturore të këtij tipi banese se si ajo e kthyer në muze etnografik.

Kulla si banesë e fortifikuar, trekatëshe, ndeshet rrallë edhe në Gjakovë. Ndërtimi i kullave në qytete është dukuri e gjysmës së dytë të shek. XIX. Këto banesa, të shtresave të pasura, janë ndërtuar krejtësisht me mur guri, duke pasur katin përdhe të pabanuar, ndërsa të ndërmjetmin për familjen dhe të sipërmin për miqtë.

Rastet e veçanta, kanë përhapje të gjerë në Gjakovë. Ato

përgjithësisht janë devijime prej tipologjisë tradicionale, pa u shfaqur me shumësinë e zgjidhjeve të veçanta në zonat ngritur mbi troje të pjerrëta, siç është rasti i lagjes Nënkala në Prizren etj.

Elementët arkitekturor të banesës gjakovare të shek. XVIII - XIX, në përgjithësi nuk shkëputen thelbësisht prej tipologjisë mbarëshqiptare dhe mbarëballkanike më gjerë, gjithë duke pasur zgjidhje të veçanta në elementë dytësorë, kryesisht si shfaqje të personaliteteve të mjeshtërve ndërtues.

Banesa tradicionale gjakovare, në shembujt që ende ruhen është një dëshmi me vlera të pazëvendësueshme historiko - kulturore. Këto vlera duhen ruajtur dhe restauruar sipas kriterëve të njohura ndërkombëtarisht për t'ua transmetuar brezave të ardhshëm në shkallën e autenticiteti që ruajnë.

Bibliografia:

1. A.Bace, A.Meksi, E.Riza, Gj.Karaiskaj, P.Thomo, "Historia e arkitekturës shqiptare", Tiranë, 1979.
2. E.Riza, "Qyteti dhe banesa shqiptare e mesjetës së vonë", Tiranë, 1991.
3. E.Riza, Monumentet e arkitekturës dhe identifikimi i tyre, "Monumentet e Kosovës", Prishtinë, 2004.
4. E.Riza - N.Haliti "Banesa qytetare kosovare e shek. XVIII - XIX", Prishtinë, 2006.